



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna Klinë

Kuvendi i Komunës

Debat me Publikun

01Nr 060-43519 /2022

Klinë me 29.12. /2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja Debat me Publikun, e mbajtur, më 11.03.2022, në sallën e Kuvendit të Komunës, me fillim në orën 10:00.

Rendi i Ditës

1. Planin i Veprimit - Shërbimet e Ekosistemit dhe Investimet Inteligjente në Komunën e Klinës

Pjesëmarrës ishin zyrtarë nga qytetarë të Komunës së Klinës

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit, theksoj njostimet përmblodhje janë bërë me kohë, qofte në shpallje fizike qoftë në formë elektronike në web faqen zyrtare të Komunës.

Ne do të mirëpresim çdo vërejtje apo sugjerim sa i përket Planit të Veprimit Shërbimet e Ekosistemit dhe Investimet Inteligjente në Komunën e Klinës cilat do ti debatojmë sot. Gjithashtu ju mund të dorëzoni me shkrim çdo vërejtje apo sugjerim në drejtorin e Arsimit dhe në shërbimin përpunë të Kuvendit.

Sa i përket prezantimit të këtij Plani unë po i kaloj fjalën menaxherit të këtij projekti nga Organizata Balkan Green Foundation (BGF z. Besfort Kosova).

Z. Besfort Kosova: Përshëndetje përfshirë gjithë! Unë jam menaxher i projektit nga Balkan Green Foundation, projekti është kapercimi i gjelbër drejt ekonomive lokale nëpërmjet investimeve të mençura, është projekt i bashkimit evropian por në bashkëpunim me Komunën e Klinës dhe Komunën e Hasit. Ky projekt është ndërkufitar dhe ka tri komponentë kryesore:

- Ngritura e kapaciteteve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve.
- Investimet e investimeve të mençura, të cilat janë realizuar në komunën e Klinës falë këtij projekti ku janë ber 70 kilovat energji solare në disa objekte si në komunë dhe QKMF.

- Plani i veprimit të gjelbër do të jetë katër vjeçar dhe me miratimin e këtij plani komuna e Klinës do të jetë pioniere, bashkë me komunën e Hasit ku do të përfitoj edhe 800 drita led, dhe 15 kilovat energji termale.

Plani i veprimit është hartuar nga dy ekspert, Avni Hajdari i cili është profesor i biologjisë dhe Vetar Zeqiri i cili është konsulent në fakultetin ekonomik. Ky plan pak a shumë përfshin rekomandime të cilat do të ndërmarrën në menyr qe të përshpejtohet ngritura dhe zhvillimi ekonomik i Klinës dhe të kapërcehet në dimensionin e ekonomisë së gjelbër. Ku do të integrohen procese të reja në mëndis, siç është smart city, që nënkupton grumbullimin e informacioneve në qytet! Po ashtu eksperti ka rekomanduar disa pika se ku mund të orientohet buxheti pak a shumë. Është mirë që ky plan pasi që të miratohet të përkthehet edhe në gjuhen angleze pasi qe mund të shërbej në të ardhmen si pik referuese për investime të mençura në Komunën e Klinës. Komuna e Klinës sa i përket energjisë solare qëndron mjaft mirë, madje i'a kemi kaluar edhe Prizrenit pasi qe ne kemi dikun 75 KW prodhim te energjisë solare, ndërsa Prizreni ka 55 KW energji solare. Po ashtu mendoj se edhe 15 KW do të kemi prodhim të energjisë termale. Pra ky është një dokument ku mund te shihet si pik referuese për hartimin e politikave të reja komunale, pra nuk është dokument i cili e detyron komunën apo imponon komunën në veprime të caktuara por vetëm një plan rekomandues. Ne kemi thirrur ketë debat qe të marrim sugjerimet tuaja nga e gjithë publiku dhe të kompletohen sa me shumë si plan.

Kryesuesi z. Fadil Gashi: Faleminderit, me të gjitha këto që u thanë dhe të gjithë ato që janë brenda planit dhe gjithçka tjetër, ne jemi orientuar qe deri në seancë do ti marrim të gjitha propozimet e juaja edhe këto që janë dhen në plan pastaj e drejta e votimit është e anëtarëve të kuvendit por mendoj se është i nevojshëm për komunën e Klinës. Unë po e zhvendos debatin tek ju urdhëroni!

Z. Zafer Gashi: Faleminderit kryesues, pëershëndetje për të gjithë! Në fakt unë erdha për diçka tjetër por bëra mirë se u ndala edhe në debat. Unë sa munda ta shfletoj ketë plan veprimi i përgëzoj profesor Zeqirin dhe profsin tjetër për një plan të formuar komplet dhe leht i implementueshem. Sa i përket energjisë solare qe u përmend, mua si qytetar po me bren një shqetësim i madh qe e kam. Ky plan me ketë emërtim dhe objektiva te mira mendoj por Kлина po merr një kaheje tjetër, p.sh ju e shkruani aty: Miratimi i këtij plani në kuvendin komunal do të jetë një pararojë në menaxhimin dhe përdorimin e kapitalit natyrorë në favor të zhvillimit vendor dhe përmasimin e shërbimit të qytetaret. Shikoni, kapitali natyror nga data 23 apo 25 të këtij viti është i rrezikuar sepse komuna e Klinës ka dhen leje për ndërtimin e një fabrike të çimentos fabrikë e cila do të dëmtoj gjenerata të tera. Ky plan po ndërlidhet shumë mirë këtu ku në disa faqe u përmend flora dhe fauna, si mund ti qëndroj kohës këto të dyja ku do të ndërtohet fabrika e çimentos. Po e përmendi një fakt shkencor nga autori Fadil Millaku d.m.th pesë bimë të cilat janë të mbrojtura nga unesco janë në atë pjesë ku do të jetë lokacioni i fabrikës. Mendoj se e ardhmja e ekosistemit në komunën e Klinës nuk do të jetë e mirë me ndërtimin e fabrikës e cila do të liroj shumë gazra helmues sepse furra ku përpunohet lënda do ta arrijë temperaturën 1600 grad celsius dhe do te liroj kemikale te ndryshme sepse furra do të nxehet me qymyrin e Obiliqit, dhe e fundit shkencërisht në trupin e njeriut ka


metale të rënda të cilat hyjnë në ndërtimin e qelizave tona, mergeli, hekuri, bakri e kështu me radhë por janë tri elemente kimike të cilat nuk gjenden ne ndërtimin e trupit si merkuri, arseniki dhe kandiumi ato lirohen nga gazrat e fabrikës së çimentos dhe sipas shkencës për dy vite janë në gjendje deri në dy metër e gjysmë të depërtoj në tokë dhe me pas fillon procesi i oksidimit të tyre të cilat janë edhe më helmuese.

Znj. Florida Gashi: Përshëndetje për të gjithë! Unë jam koordinatore lokale në kuadër të projektit kapërcim i gjelbër. Falënderoj profesorin z. Zafer Gashin me gjethë ato informata për aktualitetin në komunën e Klinës. Unë do të doja ta dija cili do të ishte rekomandimi i tije në kuadër të këtij plani për kuvendin komunal dhe Komunën e Klinës?

-Pasi përfundoj diskutimi Kryesuesi z. Fadil Gashi falënderoj të gjithë për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna theksoj se ende mundë të vazhdojnë me vërejtje dhe sugjerime, ato mund ti dërgojnë me shkrim në shërbimin e Kuvendit deri një ditë para mbledhjes së Kuvendit.

Mbledhja përfundoj në ora 11.10 h

Procesmbajtësi,
Ahmet Berisha



Kryesuesi
Fadil Gashi

